



## PROGRAMI I “FESTIVALIT TË YJEVE”

FESTIVALI I YJEVE NË FUSHË STUDËN, PARKU KOMBËTARË I SHEBENIKUT

*E Shtunë, 31 Gusht 19:00*

### **Qëllimi i Festivalit:**

Festivali i Yjeve ka si qëllim të afrojë komunitetin me bukuritë e qiellit të natës, duke nxitur interesin dhe njohuritë mbi astronominë dhe natyrën.

Festivali synon të krijojë një hapësirë për të gjitha grupmoshat, ku pjesëmarrësit mund të shijojnë përvojën e vëzhgimit të yjeve dhe të mësojnë më shumë rreth galaktikës sonë dhe përtej saj.

Ky festival ka për qëllim gjithashtu të ndërgjegjësojë për rëndësinë e mbrojtjes së natës së errët dhe uljen e ndotjes dritore që pengon vëzhgimin e qiellit.

### **Aktivitetet e Festivalit:**

#### **1. Vëzhgimi i Yjeve me Teleskopë:**

*- Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përdorin teleskopë të ndryshëm për të vëzhguar planetët, hënën, yjet dhe objekte të tjera të qiellit të natës.*

*- Një astrofizikant do të jetë i pranishëm për të shpjeguar dhe udhëhequr pjesëmarrësit gjatë vëzhgimit.*

#### **2. Trajnim nga Astrofizikantë:**

*- Punëtori për të gjithë moshat mbi bazat e astronomisë dhe përdorimin e teleskopëve.*

*- Seminare edukative nga astronomë dhe entuziastë të astronomisë që do të diskutojnë tema të ndryshme, si historia e astronomisë, eksplorimi i hapësirës dhe fenomenet astronomike.*

### **3. Kamping nën Yje:**

- *Camping nën Yje pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të kalojnë një natë në natyrë, duke u zhytur në bukuritë e qiellit të natës.*

### **4. Sky Cinema:**

- *Seanca filmike që përfshijnë filma klasikë dhe të njohur të zhanrit shkencor dhe fantastiko-shkencor, si "Interstellar," "2001: A Space Odyssey," dhe "Apollo 13."*

### **5. Fotografi Astronomike (AstroFotograf):**

- *Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të marrin pjesë në sesione të fotografisë së qiellit të natës, të udhëhequra nga fotografë të specializuar në astrofotografi.*

### **6. Natë e Artit dhe Muzikës nën Yje:**

- *Performanca muzikore të drejtpërdrejta dhe shfaqje të artit vizual të frymëzuar nga hapësira, duke krijuar një atmosferë unike nën yjet e qiellit të natës.*

### **7. Rrethi i zjarrit dhe Tregimi i Legjendave:**

- *Rrethi i Zjarrit do të krijojë një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse ku pjesëmarrësit mund të dëgjojnë legjenda dhe histori të frymëzuara nga yjet dhe hapësira.*

- *Diskutime të lira mbi përvojat personale dhe mbi njohuritë e përbashkëta për astronominë*

### **8- Këndi i Ushqimit dhe Pijeve:**

- *Menu e veçantë dhe e thjeshtë inspiruar nga hapësira dhe yjet.*

*E Djelë, 1 Shtator*

### **Aksion pastrimi në Fushë Studën**

Festivali i Yjeve është një aktivitet i dedikuar për të gjithë ata që duan të zbulojnë mrekullitë e qiellit dhe të krijojnë lidhje më të thella me natyrën dhe universin që na rrethon.